



REPUBLIKA E KOSOVËS – РЕПУБЛИКА КОСОВО – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 20 gusht 2014
Nr. ref.: 698/14

AKTVENDIM

në

Rastin Nr. KK124/14

Hetimi për pretendimet e sjelljes jokushtetuese nga gjyqtari Kadri Kryeziu

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Procedura në Gjykatë

1. Më 25 maj 2014, mediet në Kosovë pretendonin që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kadri Kryeziu, më 24 maj 2014, ishte vërejtur duke marrë pjesë në një tubim parazgjedhor në komunën e Prizrenit, ku ishin të pranishëm kryeministri në detyrë Hashim Thaçi, si dhe zyrtarë dhe kandidatë nga Partia Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK) në zgjedhjet kombëtare për Kuvendin e Kosovës, që do të mbaheshin më 8 qershor 2014.

2. Më 26 maj 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kryetari) kërkoi sqarime nga gjyqtari Kadri Kryeziu në lidhje me pretendimet e ngritura në media.
3. Më 27 maj 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu u përgjigj në kërkesën e Kryetarit për sqarime.
4. Më 2 qershor 2014, Kryetari, në pajtim me nenin 11.1.1 të Ligjit dhe me rregullin 12.1 (a), (e) dhe (g) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës), caktoi një Komision, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy (anëtar) dhe Almiro Rodrigues (anëtar), (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni). Komisionit iu dha për detyrë të mbledhë fakte dhe të përcaktojë rrethanat e pretenduara në mediet elektronike, si dhe në mediet e shkruara, në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarit Kadri Kryeziu në ngjarjet politike të sipërpërmendura. (Vendimi Nr. KK124/14).
5. Më 20 qershor 2014, Komisioni dorëzoi raportin në Gjykatë.
6. Më 25 qershor 2014, Komisioni dëgjoi gjyqtarin Kadri Kryeziu, për të përcaktuar më tej faktet dhe pretendimet se gjyqtari Kadri Kryeziu mund të jetë angazhuar në aktivitete politike në kundërshtim me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe me Kodin e mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.
7. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.
8. Më 27 qershor 2014, Komisioni dorëzoi një raport plotësues në Gjykatë.
9. Më 18 gusht 2014, Gjykata e dëgjoi gjyqtarin Kadri Kryeziu.
10. Më 19 gusht 2014, Gjykata e shqyrtoi rastin dhe votoi për këtë rast.

Baza ligjore

11. Neni 11.1.1 i Ligjit dhe rregulli 12.1 (a), (e) dhe (g) i Rregullores së punës.

Dëshmitë

12. Gjykata ka administruar, ka analizuar dhe ka vlerësuar këto fakte dhe dëshmi: mediet elektronike dhe të shkruara, të 25, 26 dhe 27 majit 2014, si dhe deklaratën e gjyqtarit Kadri Kryeziu.

Pretendimet/Faktet

13. Më 25, 26 dhe 27 maj 2014, medie të ndryshme në Kosovë pretendonin që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kadri Kryeziu, më 24 maj 2014, ishte vërejtur duke marrë pjesë në një tubim parazgjedhor në komunën e Prizrenit, ku ishin të pranishëm kryeministri në detyrë Hashim Thaçi, si dhe zyrtarë dhe kandidatë

nga PDK-ja në zgjedhjet kombëtare për Kuvendin e Kosovës, që do të mbaheshin më 8 qershor 2014. Përveç kësaj, në mënyrë specifike pretendohet që:

PRIZREN, 25 Maj – Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kadri Kryeziu, të shtunën pasdite nuk ka hezitur të marrë pjesë në një aktivitet të Partisë Demokratike të Kosovës, ku kryetari i këtij subjekti politik, Hashim Thaçi, ka promovuar programin e tij qeverisës “Misioni i Ri”. Madje ka vlerësuar se do të merrte pjesë edhe në takimet e partive të tjera, me kushtin që aty të diskutoheshin projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin e universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, në të cilin institucion arsimor është angazhuar si ligjërues i shkencave juridike. Ai ka nënvizuar se në tubimin e PDK-së është ftuar në cilësinë e profesorit të UPZ-së dhe jo në kapacitetin e gardianit të Kushtetutës.

“Prania ime në këtë tubim është diçka reale. Ka qenë një ftesë që kam marrë nga Rektorati i UPZ-së, pra jemi ftuar bashkë me rektorin dhe disa profesorë. Arsyeja pse kam vendos me marrë pjesë ka qenë fakti se bëhej fjalë për një takim me qytetarë, ku do të diskutohej edhe për ndërtimin e kampusit të UPZ-së”, ka thënë Kryeziu për “Kohën Ditore”. Ai ka shtuar se prania e tij në këtë aktivitet nuk paraqet shkelje ligjore.

“Ligji nuk ma lejon me mbështetë asnjë parti, por më lejon me qenë qytetar”, ka deklaruar Kryeziu. Tutje ai ka pohuar se fushata elektorale zyrtarisht ende nuk ka nisur, por ka pranuar se do të shkonte edhe në takimet e LDK-së, AAK-së, VV-së apo ndonjë subjekti tjetër ku trajtohet çështja e UPZ-së.

Vetëm pak ditë më parë Dega e LDK-së në Prizren pati vlerësuar se “Universiteti i Prizrenit është bërë arenë e propagandës së PDK-së”, derisa Rektorati i UPZ-së pati reaguar duke thënë se ky është një institucion akademik apolitik, që është i hapur për bashkëpunim me të gjitha subjektet pa përjashtim.

Ndërkohë Kadri Kryeziu ka insistuar se ka vepruar në përputhje me ligjin, prej se ka marrë detyrën e gjyqtarit të Kushtetueses dhe se këtë do të vazhdojë ta bëjë “deri në fund të mandatit, respektivisht në 6 apo 7 muajt e mbetur”.

Fisnik Minci, 25 maj 2014 (Koha Ditore)

Seanca dëgjimore

14. Pas mbledhjes së fakteve dhe pas dëgjimit të gjyqtarit Kadri Kryeziu, Komisioni mësoi që:
 - a. Më 8 maj 2014, kryeministri në detyrë publikoi në media sloganin e tij për fushatën politike “Misioni i Ri”
 - b. Më 10 maj 2014, kryeministri në detyrë ishte në Barilevë, komuna e Prishtinës, për të diskutuar/promovuar “Misionin e Ri”.

- c. Të njëjtën ditë, kryeministri në detyrë ishte në Ferizaj për të diskutuar/promovuar “Misionin e Ri”.
- ç. Më 13 dhe 14 maj 2014, kryeministri në detyrë ishte në Hotel Emerald në Prishtinë për të diskutuar/promovuar “Misionin e Ri”.
- d. Më 20 maj 2014, kryeministri në detyrë ishte në Prishtinë për të diskutuar/promovuar “Misionin e Ri”.
- dh. Më 22 maj 2014, kryeministri në detyrë ishte në Gjilan për të diskutuar/promovuar “Misionin e Ri”.
- e. Më 24 maj 2014 kryeministri në detyrë ishte në Therandë për të diskutuar/promovuar “Misionin e Ri”.
- ë. Të njëjtën ditë, pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës dhe para mbajtjes së zgjedhjeve nacionale më 8 qershor 2014, gjyqtari Kryeziu mori pjesë në një takim në objektin publik të Lidhjes së Prizrenit në qytetin e Prizrenit, në Kosovë.
- f. Takimi u realizua dhe u drejtua nga kryeministri në detyrë Hashim Thaçi, kryetar i PDK-së, me rendin e ditës të titulluar “Misioni i Ri”. Nga 8 maji 2014, janë mbajtur të paktën edhe 7 takime të tjera publike me rend dite të njëjtë nëpër vendtakime të ndryshme në Kosovë, të udhëhequra nga kryeministri në detyrë dhe kryetari i PDK-së, Hashim Thaçi. Ky takim ishte i hapur për publikun, e jo vetëm për zyrtarët dhe punonjësit e universitetit, dhe nuk ishte mbajtur në pronën e universitetit.
- g. Gjyqtari Kryeziu, i cili po ashtu punon si profesor në Universitetin e Prizrenit, kishte marrë pjesë në takim pasi ishte ftuar gojariht nga Zijadin Shemsedini, Rektor i Universitetit të Prizrenit. Sipas gjyqtarit Kryeziu, në këtë takim kishin marrë pjesë edhe dekanë të fakulteteve të ndryshme, si dhe personeli i Universitetit.
- gj. Sipas gjyqtarit Kryeziu, ai kishte marrë pjesë në takim për ta dëgjuar kryeministrin, Hashim Thaçi, duke folur për konceptin e zgjerimit të ndërtesës dhe kompleksit të Universitetit të Prizrenit.
- h. Në këtë takim nuk ishte marrë vendim për zgjerimin e kompleksit të Universitetit të Prizrenit dhe rendi i ditës nuk parashihte që të merrej ndonjë vendim.
- i. Në këtë takim, të udhëhequr nga kryeministri Hashim Thaçi, kishte diskutime të gjera për “Misionin e Ri” për Kosovën, d.m.th. 15 ditë para zgjedhjeve nacionale, ku do të merrnin pjesë shumë kandidatë nga partia politike e Hashim Thaçit.
- j. Gjyqtari Kryeziu theksoi që njerëzit në Prizren i drejtohen atij si “kryetar” por edhe si “profesor”, në shenjë respekti për punën e tij të mëhershme si kryetar Komune i Prizrenit dhe si profesor në Universitetin e Prizrenit.

- k. Gjyqtari Kryeziu theksoi se ai ishte plotësisht i vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrimet e tij si qytetar, por edhe si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.
- l. Gjyqtari Kryeziu theksoi se ai nuk ka marrë pjesë në takime politike që prej kohës që është bërë gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe se pjesëmarrja e tij në takimin më 24 maj 2014 ishte bërë me kërkesën e Rektorit të Universitetit të Prizrenit, me qëllimin e vetëm të mbështetjes së zgjerimit të Universitetit të Prizrenit.
- ll. I pyetur se si mund ta dinin të tjerët që merrnin pjesë në këtë takim apo që e kishin parë duke marrë pjesë në takim se ai po merrte pjesë aty vetëm si profesor i Universitetit dhe jo si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ai e pranoi se publiku nuk mund ta dijë se në çfarë cilësie ai ka marrë pjesë në këtë takim, i cili kishte një rend dite me natyrë të qartë politike, 15 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve nacionale.
- m. I pyetur se si do ta dinte publiku që pjesëmarrja e tij në këtë takim nuk kishte për qëllim që të krijonte përshtypjen se kapaciteti i tij vendimmarrës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese do të mund të ndikohej ose do të ndikohej nga partitë politike apo zyrtarët politikë, ai e pranoi se mund të jetë e arsyeshme që publiku ta vë në pikëpyetje paanësinë dhe pavarësinë e tij, edhe pse ky nuk ishte qëllimi i tij.
- n. I pyetur se si zbatohen nenet 1.2, 2.1 dhe 4.3 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese ndaj tij dhe pjesëmarrjes së tij në takimin e 24 majit 2014, ai e pranoi se mund të jetë treguar “mospërfillës” në respektimin e Kodit të mirësjelljes.
- nj. Neni 1.2 i Kodit të mirësjelljes përcakton:
- Gjyqtarët nuk duhet të përfshihen në asnjë aktivitet, ose të jenë anëtarë të ndonjë asociacioni, që do të mund të ndikonte në perceptimin dhe në besimin e qytetarëve në pavarësinë e tyre në vendimmarrje.*
- o. Neni 2.1 i Kodit të mirësjelljes përcakton:
- Gjyqtarët duhet të ushtrojnë të gjitha përgjegjësitë në mënyrë të paanshme dhe duhet të sigurohen që kjo paanshmëri të vërehet në të gjitha veprimet.*
- p. Neni 4.3 i Kodit të mirësjelljes përcakton:
- Gjyqtarët nuk duhet të jenë anëtarë të ndonjë partie ose organizate politike dhe nuk duhet të marrin pjesë në aktivitete politike.*
- q. Gjyqtari Kryeziu e pranoi që me pjesëmarrjen e tij në takimin e 24 majit 2014, ai, me gjasë, ishte treguar “mospërfillës” në respektimin e nenit 2.1 të Kodit të Mirësjelljes, i cili i ndalon një gjyqtari, qoftë edhe kur ka qëllime të mira, të krijojë përshtypjen se ai nuk do të ishte e paanshëm në rolin e tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

15. Më 18 gusht 2014, gjyqtari Kryeziu u paraqit para Gjykatës në përbërje të plotë dhe e pranoi se sjellja e tij më 24 maj 2014 përbënte shkelje, *inter alia*, të rregullit 6 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të nenit 10 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Po të njëjtën ditë, gjyqtari Kryeziu propozoi që Gjykata ta pranojë kërkimfaljen e tij për sjellje të pahijshme. Ai, po ashtu, propozoi që, për pjesën e mbetur të mandatit të tij në Gjykatë, të përjashtohet nga pjesëmarrja në seancat shqyrtuese që kanë të bëjnë me çfarëdo kërkesë të parashtruar në Gjykatë, ku janë të përfshira partitë politike apo individët në parti politike, apo nga çfarëdo rasti tjetër që ka kontekst politik, ku, *inter alia*, një palë mund të paraqitet para Gjykatës, siç është: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Avokati i Popullit dhe komunat.

Vlerësimi i rastit nga Gjykata

16. Kushtetuta, Ligji, Rregullorja e punës dhe Kodi i mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë specifike të Gjykatës, sa i përket pretendimeve për sjellje të pahijshme nga një gjyqtar i Gjykatës. Neni 118 i Kushtetutës përcakton:

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave.

17. Neni 5 i Ligjit përcakton:

1. Gjatë mandatit të tij gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të jetë:

- 1.1. anëtar i një partie, lëvizje ose çfarëdo organizate tjetër politike;*
- 1.2. anëtar i bordit drejtues të një ndërmarrje publike, shoqërie tregtare ose organizate jo qeveritare; [...]*

18. Neni 10 i Ligjit përcakton:

- 1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyre të ushtrojnë me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme funksionin e gjyqtarit dhe të vendosin sipas bindjes së lirë në pajtim me Kushtetutën.*
- 2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ruajnë reputacionin dhe dinjitetin e Gjykatës Kushtetuese.*

19. Neni 4.1 dhe neni 4.3 i Kodit të mirësjelljes përcaktojnë:

4.1 Gjyqtarët nuk duhet të përfshihen në aktivitete të tjera që nuk janë në përputhje me pavarësinë, me paanshmërinë dhe me kushtet e emërimit të tyre si gjyqtarë.

.....

4.3 Gjyqtarët nuk duhet të jenë anëtarë të ndonjë partie ose organizate politike dhe nuk duhet të marrin pjesë në aktivitete politike.

20. Neni 6.1 dhe neni 6.2 i Kodit të mirësjelljes përcaktojnë:

6.1 Gjyqtarët duhet të ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes në mënyrën e cila është plotësisht në përputhje me dinjitetin dhe me respektin e pozitës së tyre gjyqësore.

6.2 Në ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes, gjyqtarët duhet të shmangin deklaratat publike apo komentet që mund të dëmtojnë autoritetin e Gjykatës dhe që mund të ngrenë dyshime të arsyeshme për paanshmërinë e gjyqtarit.

21. Gjykata thekson që njëra nga garancitë e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese ndërlidhet me klauzolën e papajtueshmërisë, d.m.th. disa kufizime të caktuara që rrjedhin nga vetë natyra e funksionit kushtetues gjyqësor. Kjo i referohet aktiviteteve jashtëgjyqësore, qofshin ato publike apo private, të cilat në ndonjë mënyrë janë në papajtueshmëri me funksionin e të qenit gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se gjyqtarët nuk duhet të jenë të izoluar nga shoqëria në të cilën jetojnë, pasi që sistemi gjyqësor mund të funksionojë si duhet vetëm nëse gjyqtarët janë në kontakt me realitetin. Megjithatë, aktivitetet e tilla mund ta rrezikojnë paanshmërinë e tyre, apo ndonjëherë edhe pavarësinë e tyre. Prandaj, duhet të vendoset një baraspeshë e arsyeshme ndërmjet asaj se sa mund të përfshihen gjyqtarët në shoqëri, si dhe nevojës që ata të jenë dhe të konsiderohen si të pavarur dhe të paanshëm në kryerjen e detyrave të tyre. Në këtë drejtim, në kontekstin e caktuar social dhe në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm e të informuar, duhet të shikohet se a është angazhuar gjyqtari në një aktivitet i cili në mënyrë objektive do të mund ta cenonte pavarësinë apo paanshmërinë e tij. Nëse një gjyqtar është i pasigurt, Gjykata do të duhej t'i siguronte organet apo personat që kanë funksion konsultativ dhe këshillimor, dhe që janë në dispozicion të gjyqtarëve kurdo që ata kanë ndonjë pasiguri në lidhje me atë se a është një aktivitet i caktuar nga sfera private në pajtueshmëri me statusin e tyre si gjyqtar. Më tej, sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarëve në debate publike të një natyre politike, ata nuk do të duhej të ekspozoheshin ndaj sulmeve politike të cilat nuk janë në pajtim me neutralitetin e kërkuar nga gjyqësori në mënyrë që ta ruajnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, gjyqtarët do të duhej të përmbaheshin nga çfarëdo aktiviteti politik që mund të cenojë pavarësinë e tyre apo që e rrezikon përshtypjen e paanshmërisë së tyre. *(Shih, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian për dijeni të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, e në veçanti me etikën, sjelljen a papajtueshme dhe paanshmërinë, Strasburg, 19 nëntor 2002).*
23. Në një raport të paraqitur në Konferencën Botërore për Drejtësinë Kushtetuese, në emër të Gjykatës Supreme të Kanadasë, gjyqtari Ian Binnie thekson: *“Kufizimet ndaj aktiviteteve jashtë-gjyqësore të një natyre politike janë të rrepta - gjyqtarët e kanë të ndaluar të angazhohen në aktivitete politike partizane gjatë mandatit të tyre. Ata nuk duhet të anëtarë të ndonjë partie politike, të marrin pjesë në tubime politike, të kontribuojnë në fushata, të marrin pjesë në diskutime politike në publik, apo të nënshkruajnë peticione. Për më tepër, edhe pse bashkëshortët / bashkëshortet dhe anëtarët e tjerë të familjes së një gjyqtari kanë të drejtë të marrin pjesë në politikë, ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për ndikimin që aktivitetet e tyre politike mund të kenë në perceptimin e paanshmërisë së gjyqtarit. Në fund, nga gjyqtarët pritet që ta diskualifikojnë vetëvehten kur besojnë se një person i arsyeshëm, me gjykim të*

drejtë, dhe i informuar do të mund të mendonte në mënyrë të arsyeshme se gjyqtari do të ishte në konflikt interesi.” (Shih Pavarësia Gjyqësore në Kanada, e paraqitur nga gjyqtari Ian Binnie, në emër të Gjykatës Supreme të Kanadasë).

24. Në rastin konkret, edhe pse pretendimet janë shumë të rënda, dhe nëse janë të vërteta, mund të paraqesin shkelje të Kodit të mirësjelljes e ndoshta edhe të Ligjit, megjithatë, ato nuk pretendojnë kryerjen e krimeve të rënda apo mospërfilljen e rëndë të detyrave të punës, apo ndonjë kusht që do ta bënte të pamundur që gjyqtari Kryeziu të veprojë si gjyqtar i Gjykatës. Prandaj, Gjykata duhet të përgjigjet në pyetjen se a janë të përshtatshme në këtë rast sanksionet apo masat disiplinore të ndryshme nga rekomandimi për shkarkim, në përputhje me rregullin 6, ku në mënyrë specifike përcaktohet:

(1) Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet vetëm në këto raste:

- (a) në rast të kryerjes së ndonjë krimi të rëndë,*
- (b) në rast të mospërfilljes së rëndë të detyrave të punës,*
- (c) në rast të humbjes së përhershme të aftësisë për të vepruar, ose*
- (d) në rast të sëmundjes a të ndonjë problemi tjetër shëndetësor, që e bën të pamundur ushtrimin e përgjegjësisë dhe të funksionit të gjyqtarit.*

25. Siç përcaktohet shprehimisht, si në Ligj po ashtu edhe në Kodin e mirësjelljes, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, dhe me veprimet e tyre ata nuk duhet të krijojnë asnjë dyshim në lidhje me paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre ndaj cilitdo person apo palë.
26. Në rastin konkret, Gjykata nuk ka gjetur dëshmi se gjyqtari Kadri Kryeziu ka qenë apo është anëtar i një partie politike derisa është duke shërbyer si gjykatës në Gjykatë. Në fakt, gjyqtari Kadri Kryeziu e ka pranuar se sjellja e tij më 24 maj 2014 ka shkelur, *inter alia*, nenin 6 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nenin 10 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
27. Sipas rregullit 6(5) të Rregullores së punës, Gjykata ka kompetenca të marrë masa të përshtatshme disiplinore, siç është qortimi publik apo privat, për të siguruar respektimin e Ligjit dhe të Kodit, si dhe për të siguruar respektimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së Gjykatës në rast se dëshmohen pretendimet për sjellje të pahijshme apo për krijimin e përshtypjes së sjelljes së keqe.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me rregullin 6 të Kodit të mirësjelljes, në përputhje me nenin 11.1.1 të Ligjit dhe me rregullin 12.1 (a), (e) dhe (g) të Rregullores së punës dhe pas shqyrtimit të pretendimeve dhe përgjigjeve të gjyqtarit Kryeziu, njëzëri

VENDOS

- I. TË PRANOJË kërkimfaljen e gjyqtarit Kadri Kryeziu;
- II. TË QORTOJË gjyqtarin Kadri Kryeziu për shkeljen e nenit 1 dhe 4 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese; dhe,
- III. TË PËRJASHTOJË gjyqtarin Kadri Kryeziu nga pjesëmarrja në seancat shqyrtuese për të gjitha kërkesat e ardhshme të Gjykatës Kushtetuese ku përfshihen partitë politike apo individët në parti politike apo nga çdo rast tjetër që ka kontekst politik, ku, *inter alia*, një palë mund të paraqitet para Gjykatës, siç është: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Avokati i Popullit dhe komunat.
- IV. T'IA KUMTOJË këtë aktvendim gjyqtarit Kadri Kryeziu dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari kryesues i Komisionit

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Robert Carolan



Prof. Dr. Enver Hasani